

URDHËR
Nr. 227, datë 24.10.2024

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 12, pika 1 dhe nenit 13, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 7, pika 2, germa “c” e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtares Mimoza Tasi, nga data 28.10.2024 deri më 29.10.2024. Kjo kompetencë nuk mund të nëndelegohet.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja Mimoza Tasi dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIT
Sokol Çomo